

Emërtimi dhe Forma ligjore

PRESPA INVEST SHPK

NIPT -i

K72117025C

Adresa e Selisë

Rruga Gjergj Balshaj, pranë Ura Kamëz, Tiranë

Data e krijimit

11 Shtator 2007

Veprimtaria Kryesore

Qiradhënie, Organizim eventesh

PASQYRAT FINANCIARE

(Në zbatim të Standartit Kombëtar të Kontabilitetit Nr.2 dhe
Ligjit Nr. 9228 Datë 29.04.2004 Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare)

31 DHJETOR 2015

Pasqyra Financiare janë individuale

Po

Pasqyra Financiare janë te konsoliduar

Jo

Pasqyra Financiare janë të shprehura në

Lekë

Periudha Kontabël e Pasqyrave Financiare

Nga

01.01.2015

Deri

31.12.2015

Data e mbylljes së Pasqyrave Financiare

02.03.2016

Pasqyra e pozicionit financiar në datë 31 Dhjetor 2015

Në LEK	Shënime	2015	2014
I. AKTIVET			
i. Aktivet Afatshkurtra			
Mjetet monetare		16,650,070	31,009,601
Arkëtime për aktive financiare afatgjata		90,823,563	0
Të drejta të arkëtueshme		37,901,020	28,162,557
Inventarët		102,427	7,208,047
Shpenzime të shtyra		903,448	2,926,767
Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara		6,319,275	4,212,927
		152,699,803	73,519,898
ii. Aktive Afatgjata			
Aktivitet financiar		170,721,563	266,338,626
Aktivitet materiale		1,500,704,579	1,578,143,132
		1,671,426,142	1,844,481,758
Total aktive		1,824,125,945	1,918,001,656
II. DETYRIMET DHE KAPITALI			
i. Detyrimet Afatshkurtra			
Titujt e huamarrjes		1,751,954	9,800,494
Detyrime ndaj institucioneve të kredisë		160,671,762	53,603,550
Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit		22,463,215	17,267,262
Të pagueshme për shpenzime të konstatuara		676,712	766,153
Grande dhe të ardhura të shtyra		0	5,777,333
		185,563,642	87,214,793
ii. Detyrimet Afatgjata			
Detyrime ndaj institucioneve të kredisë		801,028,800	889,188,300
Grande dhe të ardhura të shtyra		0	51,033,114
		801,028,800	940,221,414
Total detyrime		986,592,442	1,027,436,207
iii. Kapitali dhe rezervat			
Kapitali ligjor		100,000	100,000
Rezerva të tjera		11,710,054	34,811,299
Rezerva rivlerësimi		834,817,625	878,755,397
Fitimi i pashpërndarë		43,937,770	46,218,702
Humbja e periudhës		-53,031,947	-69,319,949
		837,533,503	890,565,449
Total detyrimet dhe kapitali		1,824,125,945	1,918,001,656

Kontabilist
Erta Hysesani

Erta Hysesani
[Signature]

Prespa Invest Sh.p.k.

Pasqyra Financiare të mblydura në datë 31 Dhjetor 2015
Shënimet shpjeguese janë pjesë përbërëse e kësaj pasqyre
Faqe 3 nga 10

Administratori
Endri Prespa

Endri Prespa
[Signature]



Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse
për vitin e mbyllur në datë 31 Dhjetor 2015

Në LEK	Shënimet	2015	2014
Humbja e periudhës		-53,031,947	-69,319,950
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse			
Efekti nga rivlerësimi i godinës		43,937,770	46,218,704
E ardhura totale për vitin		-9,094,177	-23,101,246

Kontabilist
Erta Hysesani

Erta Hysesani
[Signature]

Administrator
Endri Prespa

Endri Prespa
[Signature]



Politikat kontabël dhe shënime shpjeguese për pasqyrat financiare

(Të gjitha shumat në Lekë përveç nëse cilësuar ndryshe)

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria Prespa Invest është themeluar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, në datë 11.09.2007, me kapital fillestar të nënshkruar në vlerën 100,000 lekë me ortak të vetëm Zotin Dragush Prespa i cili zotëron 100 % të kuotave të kapitalit. Kapitali ligjor nuk ka pësuar ndryshime.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse të Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008, *Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*, nga statuti i saj dhe legjislacioni shqiptar në fuqi. Objekti i veprimtarisë së saj përfshin dhënie me qira të pasurive të paluajtshme, organizim eventesh kryesisht panairesh etj. Gjatë vitit 2015, veprimtaria kryesore shoqërisë është organizimi i eventeve dhe panairesh me kohëzgjatje 3-12 dite .

Kjo shoqëri është regjistruar me numër unik K72117025C, me adresën e selisë në Tiranë, Rruga Gjergj Balshaj, pranë Ura Kamëz, Tiranë. Struktura organike, organizimi, drejtimi dhe kontrolli i brendshëm i përshtatet natyrës dhe realizimit të objektit të veprimtarisë së saj. Organet drejtuese janë Asambleja e Përgjithshme dhe për drejtimin ekzekutiv është Drejtoria Administrative me përfaqësues ligjor, administratorin e saj, Zotin Endri Prespa.

2. Përmbledhje e politikave kryesore kontabël

Pasqyrat financiare të shoqërisë janë përgatitur në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit në Shqipëri (SKK). Në rastet kur SKK nuk parashikojnë çështje të veçanta, janë zbatuar parashikimet në Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar për njësitë ekonomike të vogla dhe të mesme.

Pasqyrat financiare janë përgatitur në Lekë Shqiptare.

2.a. Bazat e përgatitjes

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtimi të kryejë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme nga vlerësimet. Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen. Pasqyrat financiare janë përgatitur në Lekë Shqiptare.

2.b. Bazat e matjeve

Në përgatitjen e pasqyrave financiare janë zbatuar parimet kontabël që njihen si më të përshtatshme për të matur dhe paraqitur gjendjen financiare, rezultatit financiar dhe flukset e parasë mbi gjendjen e kontabilitetit rrjedhës (të drejtat dhe detyrimet e konstatuara).

2.c. Njohja e të ardhurave

Të ardhurat përfaqësojnë flukse hyrëse (rritjen e përfitimeve ekonomike) gjatë periudhës së raportimit, që çojnë në rritjen e aktiveve ose pakësimin e pasiveve, si dhe që rrisin kapitalin e njësisë ekonomike raportuese, duke përjashtuar këtu ato që lidhen me kontributet nga pjesëmarrësit në kapital. Të ardhurat përfshijnë vetëm hyrjet bruto të përfitimeve ekonomike të marra dhe ato që janë për t'u marrë nga njësia ekonomike për llogari të vet. Shumat e mbledhura për llogari të palëve të treta si taksat e shitjes, taksat e mallrave, produkteve dhe shërbimeve, si dhe tatimi i vlerës së shtuar nuk janë përfitime ekonomike që hyjnë në njësinë ekonomike dhe nuk sjellin rritje të kapitalit neto. Për këtë arsye ato nuk përfshihen në të ardhurat.

2.d. Tatimi mbi të ardhurat

Shpenzimi i tatimit mbi të ardhurat paraqet shumën e tatimit aktualisht të pagueshëm. Tatimi aktualisht i pagueshëm bazohet në fitimin e tatueshëm për vitin.



2.e. Ndërtesa, Pajisje, Makineri dhe Të tjera Aktive Afatgjata Materiale

Pajisjet dhe makineritë janë regjistruar me kosto dhe janë amortizuar (detajuar në vijim) me norma të cilat përfaqësojnë konsumin e përfitimeve ekonomike të pajisjeve dhe makinerive gjatë jetës së tyre të dobishme.

Ndërtesa është paraqitur me vlerën e drejtë, mbështetur në raportin e vlerësimit nga vlerësues të licencuar. Kur rivlerësohet një element i AAM-së, amortizimi i akumuluar në datën e rivlerësimit eliminohet kundrejt vlerës kontabël bruto të aktivit dhe vlera neto ri deklarohet me shumën e rivlerësuar të aktivit. Shuma/vlera e rregullimit, që vjen nga ri deklarimi ose eliminimi i amortizimit të akumuluar, përfaqëson shtimin ose pakësimin e vlerës kontabël, e cila kontabilizohet si më poshtë:

- Në se vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material rritet, si rezultat i rivlerësimit, kjo rritje kreditohet drejtpërdrejt në kapitalet e veta nën zërin "tepricë nga rivlerësimi". Por shuma e rivlerësimit njihet si e ardhur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, për sa kohë dhe në atë masë që ajo anulon humbje nga rivlerësimi i të njëjtit aktiv në periudhat kontabël paraardhëse.
- Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material zvogëlohet, si rezultat i rivlerësimit, ky zvogëlim njihet si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Por shuma e humbjes nga rivlerësimi debitohet drejtpërdrejt në kapitalet e veta nën zërin "tepricë nga rivlerësimi", për sa kohë dhe në atë masë që ajo kompenson një gjendje kreditore që mund të ekzistojë nga rivlerësime të mëparshme të këtij aktivi.

Teprica nga rivlerësimi, e përfshirë në kapitalet e veta për një element të AAM-së, duhet të kalohet te fitimet e pashpërndara përgjatë jetës së dobishme të aktivit afatgjatë material. Teprica e transferuar çdo vit është diferenca mes amortizimit të llogaritur mbi bazën e vlerës kontabël të rivlerësuar të aktivit dhe amortizimit të llogaritur, bazuar mbi koston fillestare të aktivit. Të gjitha tepricat e tjera (nëse ka), të mbetura nga rivlerësimi, duhet të transferohen te fitimet e pashpërndara kur aktivi afatgjatë material çregjistrohet. Transferimet nga tepricat e rivlerësimeve në fitimet e pashpërndara nuk bëhen nëpërmjet pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve

Amortizimi ngarkohet në mënyrë që të shpërndahet kosto e aktiveve pakësuar me vlerën e tyre të mbetur në fund të jetës, përgjatë jetës së dobishme, duke përdorur metodën e vlerës së mbetur. Për amortizimin e aktiveve afatgjata materiale janë përdorur normat vjetore të mëposhtëme.

Ndërtesa	5%
pajisje informatike	25%
Të tjera	20%

2.f. Qiratë

Qiratë janë klasifikuar si qira të zakonshme kur pjesa më domethënëse e riskut dhe e përfitimit që vjen nga pronësia e sendit janë mbajtur nga qiradhënësi. Pagesat për këto qira janë njohur në pasqyrën e rezultatit.

2.g. Inventarët

Inventarët paraqiten me më të ulët e koston dhe çmimit të shitjes minus kostot e përfundimit dhe të shitjes. Kosto llogaritet duke përdorur metodën e koston mesatare.

2.h. Instrumentet financiare

Instrumentet financiare përfshijnë llogaritë bankare, para në dorë, llogari të arkëtueshme, parapagimet dhe llogari të pagueshme. Të gjithë instrumentet financiare janë njohur në pasqyrat financiare me kosto.

2.i. Llogari të arkëtueshme tregtare dhe të tjera

Arkëtimi i të ardhurave, nga qiraja, bëhet në bazë të afateve normale të kredisë, dhe llogaritë e arkëtueshme nuk mbartin interes. Kur kredia zgjatet përtej afateve normale të kredisë, llogaritë e arkëtueshme maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Në fund të çdo periudhe raportimi, vlerat kontabël të llogarive të arkëtueshme tregtare dhe llogarive të tjera të arkëtueshme rishikohen për të përcaktuar nëse ka ndonjë evidencë objektive që tregon se shumat nuk janë të rikuperueshme. Nëse është kështu, njihet menjëherë një humbje nga zhvlerësimi në fitim ose humbje.



2.j. Llogaritë e pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare janë detyrime në bazë të afateve normale të kredisë dhe nuk mbartin interes. Llogaritë e pagueshme tregtare të shprehura në një monedhë të huaj përkthehen në monedhën Lekë, duke përdorur kursin e këmbimit në datën e raportimit. Fitimet ose humbjet nga këmbimi i monedhave të huaja përfshihen në të fitim ose humbjet nga këmbimi.

2.k. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj kthehen në Lekë me kursin e këmbimit në datën e kryerjes së transaksionit. Në çdo datë raportimi, zërat monetarë të pasqyrës së pozicionit financiar të shprehur në monedhë të huaj rivekëtohen në Lekë me kursin në datën e raportimit. Diferencat e rezultuara nga përkthimi janë njohur në pasqyrën e rezultatit. Kurset e këmbimit më të rëndësishme të përdorura janë :

Monedha	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
EUR	137.28	140.14
USD	125.79	115.23
GBP	186.59	179.48

2.l. Grantet dhe forma të tjera të ndihmës

Grandet nuk duhet të njihen deri sa të ketë siguri të mjaftueshme që:

- njësia ekonomike do të përmbushë kushtet e paracaktuara në lidhje me grandet;
- grandet do të merren/përftohen.

Grandet duhet të njihen si të ardhura dhe nuk duhet të kreditohen direkt në kapitalin aksionar. Grandet duhet të njihen si të ardhura në mënyrë sistematike gjatë periudhës kontabël, në të njëjtën mënyrë siç do të regjistrohen edhe shpenzimet që këto grande do të kompensojnë.

3. Mjetet monetare

Këtu përfshihet gjendja e mjeteve monetare në arkë dhe në banka. Një analizë e detajuar e gjendjes së likuiditeteve jepet në pasqyrën më poshtë.

	2015		2014		
	ALL	EUR	ALL	EUR	USD
Arka	12,634,273	12,052	16,173,881	3,880	0
Totali Lekë	14,288,753		16,717,604		
Bankat					
ABI Bank	8,711	0	7,039	-	-
Raiffeisen Bank	170,924	15,000	10,197,298	26,433	837
Tirana Bank	7,723	4	12,410	1,236	-
BKT	112,519	12	101,225	-	-
	299,877	15,016	10,317,972	27,669	837
Totali Lekë	2,361,317		14,291,996		
Totali	16,650,070		31,009,601		

Shoqëria ka përdorur dhe llogari bankare të zbuluara (shiko shënimin 10), shumë e cila nuk është paraqitur në këtë post. Ato janë paraqitur si detyrime afatshkurtra.

4. Të drejta të arkëtueshme

Në këtë zë të bilancit përfshihen të gjitha të drejtat afatshkurtra të njësisë ndaj të tretëve, të cilat kanë rrjedhur nga veprimet tregtare ose nga investimet afatshkurtra në letrat me vlerë. Një analizë me e detajuar e këtyre të drejtave paraqitet në vijim.

	2015	2014
Llogari të arkëtueshme (a)	15,209,393	6,823,290
Huadhënie afatshkurta (b)	4,648,928	4,598,928
TVSh kreditore	1,569,128	4,582,518
Interesa të maturuara (c)	16,473,571	12,157,821
Totali	37,901,020	28,162,557

4.a. Llogari të arkëtueshme

Në këtë nënzë përfshihen të gjitha të drejtat ndaj klientëve për shitjen e shërbimeve me arkëtim të mëvonshëm, të detajuar si më poshtë.

	2015	2014
Praktiker Albanien (i)	53,585,520	55,028,316
Iceberg Communication shpk	3,448,184	2,522,520
Elbasan Cement Factory	2,736,000	0
Albanian Motors Company	2,053,846	0
Fushë-Kruja Cement Factory	1,444,450	700,700
TRING TV sha	1,402,900	0
Event Market	975,016	0
Media Vizion	800,933	0
Tirana Auto	0	770,770
Zhvlerësim Praktiker Albanien shpk	-54,727,225	-54,727,225
Klientë të tjerë	3,489,771	2,528,209
Totali	15,209,393	6,823,290

- (i) Shoqëria ka njohur në vitin 2013 një zhvlerësim të këtyre të drejtave (shpenzim i panjohur) ndaj klientit Praktiker Albanien shpk në vlerë totale 75,075,366 Lekë nga të cilat 21,268,357 Lekë janë arkëtuar nga klienti në vitin 2014, si rezultat kjo vlerë është njohur si rimarrje e shpenzimeve në pasqyrën e të ardhurave të vitit 2014 (te patatueshme).

Duke filluar nga muaji Gusht 2013, shoqëria ka ndërprerë faturimin e qerasë për klientin Praktiker Albanien, dhe nga ajo periudhë nuk ka arritur të gjeje qiramarrës të tjerë. Kjo ka shkaktuar vështirësi financiare për shoqërinë Prespa Invest dhe po bën të vështirë vijimësinë e aktivitetit të saj. Aktualisht shoqëria është duke ndjekur në rrugë ligjore respektimin e kontratës:

Gjykata e Tiranës me vendimin e saj datë 18 Mars 2014, ka miratuar çeljen e procedurës së falimentimit për shoqërinë Praktiker Albanien shpk dhe shoqëria Prespa Invest shpk është njohur si kreditor nga Gjykata.

Shoqëria Prespa Invest, gjithashtu ka nisur proces gjyqësor në Gjermani ndaj shoqërisë mëmë Praktiker AG ku tashmë është njohur si kreditor.

4.b. Huadhënie afatshkurta

Paraqiten të drejta nga huadhënie afatshkurtra, të mbartura nga vitet e kaluara. Kjo hua trajtohet pa interes dhe shuma pritët të arkëtohet gjatë vitit 2016.

4.c. Interesa të maturuara

Për shumën 16,473,571 Lekë jepen të drejtat nga maturimi i interesave të pa arkëtuara për aktivet afatgjata financiare, deri në datë 31 Dhjetor 2015 (shënimi8) (Dhjetor 2014: 12,157,821 Lekë).

5. Inventarët

Shoqëria disponon gjendje inventari lëndë të para në mbyllje të pasqyrave financiare.

	2015	2014
Mallra	0	203,363
Lëndë e parë	102,427	310,263
Inventar për shitje	0	6,694,420
Totali	102,427	7,208,047

Inventari është vlerësuar me kosto. Gjatë periudhës kontabël vlera e inventarit e përfshirë në pasqyrën e performancës është 16,834,344 Lekë (shënimi 19).

6. Shpenzime të shtyra

Në këtë zë të bilancit përfshihen tepricat e llogarive që evidentojnë gjendjen dhe ndryshimet në shumat e parapagimeve, të drejtave të rritura dhe shpenzimet e shtyra në datën e bilancit

	2015	2014
Parapagime për shërbime	0	180,598
Parapagime Tatim Fitimi	315,993	1,868,690
Shpenzime të parapaguara (a)	587,455	877,479
Totali	903,448	2,926,767

6.a. Shpenzime të parapaguara

Jepet gjendja e mbetur e shpenzimeve të parapaguara në datë 31 Dhjetor 2015. Përbëhet nga siguracione objekti 1-vjeçare kryer në shoqërinë e sigurimit Sigal Uniq Grup Austria, gjatë vitit 2015. Njohja e tij, në shpenzimet e periudhës, është bërë në mënyrë lineare përgjatë kohëzgjatjes së këtij siguracioni. Në vitin 2015, si shpenzim rrjedhës i kësaj periudhe është njohur shuma 1,699,921 Lekë.

7. Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara

Këtu janë paraqitur interesa aktive të llogaritura por të pamaturuara, për aktivet afatgjata financiar të paraqitur në shënimin 8 të njohur dhe vlerësuar deri në datë 31 Dhjetor 2015 sipas metodës së interesit efektiv në shumën 6,319,275 Lekë. (31 Dhjetor 2014: 4,212,927 Lekë)

8. Aktivët financiare

Shoqëria disponon aktive afatgjata financiare, për huadhënie afatgjata si më poshtë:

	2015	2014
Prespa Import Eksport (a)	96,809,126	98,170,626
< 1 Vit	8,455,563	0
2 < > 5 Vjet	88,353,563	98,170,626
> 5 Vjet	0	0
Seament Albania (b)	164,736,000	168,168,000
< 1 Vit	82,368,000	0
2 < > 5 Vjet	82,368,000	168,168,000
> 5 Vjet	0	0
Totali	261,545,126	266,338,626

8.a. Prespa Import Eksport

Këtu paraqitet financimi me vlerë 96,809,126 Lekë ndaj shoqërisë Prespa Import Eksport, në vitin 2008, sipas kontratës fillestare midis palëve të datës 10 Mars 2008. Financimi është dhënë për një periudhë fillestare prej 5 vjetësh, me të drejtë të zgjatjes së afatit me miratim të huadhënësit, sipas kërkesës së huamarrësit. Palët në marrëveshje midis tyre kanë vendosur shtyrjen e afatit të huasë dhe mënyrën e shlyerjes së saj. Gjatë vitit 2015 është arkëtuar pjesërisht shuma 1,361,500 Lekë.

Huaja do të fillojë të shlyhet në pesë kështe duke filluar nga viti 2016 deri në vitin 2020. Nuk ka detyrime për interesa të maturuara deri në datën e mbylljes së pasqyrave financiare. Gjatë vitit 2016 do të arkëtohet shuma 8,455,563 Lekë.

8.b. Seament Albania

Këtu paraqitet huadhënia afatgjatë për shoqërisë Seament Albania në vitin 2011 sipas kontratës mes palëve të datës 06 Shtator 2011. Huaja është dhënë për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e lëvrimit të saj, sipas marrëveshjes mes palëve. Shuma reale e është 1,200,000 Euro. Kursi i përdorur 137.28 Lekë/Euro. Norma e interesit 10%. Interesat e maturuara dhe të papaguara deri në datën 31 Dhjetor 2015 janë 16,473,571 Lekë (shënimi 4.c). Paga e shumës vjetore interesit arkëtohet në datën 15 Shtator të vitit korrent.

Kthimi i shumës, nëse palët nuk do të vendosin të ndryshojnë afatin, do të jetë në dy kështe:

- Kësti i parë, në 50% të shumës së huasë, i kthyeshëm në përfundim të afatit 5 vjeçar;
- Kësti i dytë, në 50% të shumës së huasë, i kthyeshëm në përfundim të afatit 6 vjeçar;

Referuar kontratës mes palëve në vitin 2016 do të arkëtohet 50% e shumës ose 82,368,000 Lekë.

9. Aktivet materiale

Në këtë grup të Pasqyrës së pozicionit financiar paraqiten aktivet, që plotësojnë kushtin e njohjes së tyre si aktive materiale afatgjata sipas SKK5. Paraqitja në bilanc bëhet për vlerën neto të tyre nga amortizimi dhe zhvlerësimi i akumuluar.

	Ndërtesa	Makineri dhe pajisje	Mjete transporti	Të tjera në shfrytëzim	Totali
Kosto					
Në 1 Janar 2015	1,968,377,804	858,918	14,452,423	13,050,136	1,996,739,280
Shtesa nga blerjet	0	34,000	2,825,129	2,281,125	5,140,254
Pakësime për shitje	0	0	-1,011,744	0	-1,011,744
Nxjerrje jashtë përdorimit	0	-21,667	0	-320,840	-342,506
31 Dhjetor 2015	1,968,377,804	871,251	16,265,808	15,010,421	2,000,525,283
Amortizimi i akumuluar					
Në 1 Janar 2015	-404,542,294	-139,216	-8,285,625	-5,629,013	-418,596,148
Shtesa e llogaritur	-78,191,775	-143,472	-1,484,830	-1,738,629	-81,558,707
Pakësime për shitje	0	0	102,006	0	102,006
Nxjerrje jashtë përdorimit	0	14,831	0	217,308	232,139
31 Dhjetor 2015	-482,734,069	-267,858	-9,668,449	-7,150,334	-499,820,710
Vlera neto					
01 Janar 2015	1,563,835,510	719,702	6,166,798	7,421,122	1,578,143,132
31 Dhjetor 2015	1,485,643,735	603,393	6,597,358	7,860,087	1,500,704,579

Inventari i aktiveve afatgjate materiale është vlerësuar me koston e marrjes së tyre, më përjashtim të Ndërtesës, e cila është paraqitur me vlerën e drejtë. Rivlerësimi i fundit i godinës është kryer në vitin 2013.

Amortizimi i Aktiveve afatgjate materiale është llogaritur sipas normave të amortizimit, të vendosura në pikën 2.5 të politikave kontabël. Asnjë nga aktivet afatgjate materiale nuk është lënë peng ndaj palëve të treta.




10. Titujt e huamarrjes

Paraqiten detyrimet e njësise për Huatë me afat të shkurtër të marra nga bankat dhe interesat pasive të maturuara deri në datën e mbylljes së pasqyrave financiare. Sipas nen zërave kryesorë të këtij zëri, paraqitja është si vijon.

	2015	2014
Interesa të maturuara	0	9,624,899
Llogari bankare të zbuluara (overdrafte bankare)	1,751,954	175,595
Totali	1,751,954	9,800,494

11. Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit

Në këtë grup përfshihen të gjitha llogaritë që paraqesin detyrimet tregtare të njësise ekonomike ndaj të tretëve për mallrat dhe shërbimet e blera e të papaguara, për paradhëniet e marra, detyrimet ndaj punonjësve të vet, detyrimet ndaj shtetit për tatimet e taksat e ndryshme të papaguara, dhe hua të tjera.

	2015	2014
Të pagueshme ndaj furnitorëve (a)	19,253,223	15,999,409
Të pagueshme ndaj punonjësve	1,147,714	255,362
Të pagueshme për detyrimet tatimore (b)	798,180	445,422
Arkëtime në avancë për porosi	627,165	0
Garanci afatshkurtra	0	567,069
Tatim në burim llogaritur	636,934	
Totali	22,463,215	17,267,262

11.a. Të pagueshme ndaj furnitorëve

	2015	2014
Prespa Import Eksport	3,405,342	6,242,442
Media Vision	2,936,046	0
Horn & Co	886,064	805,264
MUNDIAL DOO	718,798	0
Boga&Associates	688,047	0
ARB Security shpk	569,200	0
Teha Konstruksion	547,092	547,092
Dragush Prespa	2,203,518	0
Furnitorë të tjerë	7,299,115	8,404,612
Totali	19,253,223	15,999,409

11.b. Të pagueshme për detyrimet tatimore

Në këtë zë përfshihen të gjitha detyrimet e njësise ekonomike për të gjitha llojet e tatimeve dhe taksave të llogaritura e të papaguara ndaj shtetit të detajuara si më poshtë, të cilat do të shlyhen brenda 12 muajve nga data e ndërtimit të Pasqyrave Financiare. Në mënyrë analitike, në këtë nënzë do të përmbledhen tepricat kreditore të llogarive vijuese.

	2015	2014
Sigurime shoqërore dhe shëndetsore	0	180,919
Tatim mbi të ardhurat personale	49,084	87,287
Shteti- TVSh për tu paguar	0	0
Tatimi në burim	218,041	99,605
Gjoba dhe rivlerësime	531,055	77,611
Totali	798,180	445,422

12. Detyrime ndaj institucioneve të kredisë

Në këtë post paraqitet detyrimi për huanë afatgjatë ndaj ABI Bank (ish Credit Agricole, Ish Emporiki) e skeduar si më poshtë.

	2015	2014
< 1 Vit	160,671,762	53,603,550
> 1 Vit	801,028,800	889,188,300
1 vit < > 5 Vjet	350,064,000	357,357,000
> 5 Vjet	450,964,800	531,831,300
Totali	961,700,562	942,791,850

Detyrimi real është 7,005,395 Euro. Kursi i përdorur është 137.28 Lekë/Euro. Pjesa e huasë afatshkurtër përfshin detyrimin për këstet normale të periudhës 2015, Prill - Dhjetor dhe 2016; Janar – Dhjetor.

12.a. Historiku i huasë

Kredia është miratuar në vitin 2008, në formën e dy linjave të kredisë, për financimin e objekti të ndërtuar. Linja e parë 6,120,000 Euro dhe tjetra 1,500,000 Euro. Kontrata përkatëse e kredisë Nr. Rep. 3902 Nr. Kol. 2906 datë 29 Gusht 2008, parashikon një periudhë pagese vetëm të interesave (grace period) deri në muajin Nëntor 2011, kur edhe ka filluar shlyerja e principalit për linjën e parë (6,120,000 Euro) me pagesë fikse të principalit prej 42,500 euro në muaj, kurse linja tjetër e kredisë (1,500,000 Euro) me të drejtë shlyerje principal deri në fund të afatit të kredisë. Afati i kredisë është 180 Muaj nga disburimi i parë, deri në muajin Tetor 2023.

12.b. Menaxhimi i huasë

Shoqëria është në negociata me bankën për ristrukturimin e kësaj kredie, meqenëse është në vonesë më shumë se 9 muaj në pagesën e kësteve normale sipas parashikimeve të kontratës mes palëve. Në vitin 2015 është nënshkruar një kontratë për shtyrjen pjesore të pagesës së principalit, duke paguar vetëm interesa.

13. Grande dhe të ardhura të shtyra

Në vitin 2007 shoqëria ka marrë në formë Grandi një fond prej 700,000 Euro për kosto të shtuara për ndërtimin e objektit "Godinë Tregtare Administrative, Industriale 1 dhe 2 kat, pranë Ura-Kamëz", sipas kërkesave të klientit Praktiker Albanien.

Rimarrja e tij në të ardhura ka filluar në muajin Nëntor 2009, kur edhe godina është vënë në shfrytëzim. Në vitin 2015 është njohur e gjithë shuma e mbetur e grantit prej 56,810,447 Lekë është njohur në të ardhurat e periudhës.

14. Rezerva të tjera

Paraqiten rezervimet kontabël nga fitimi i realizuar, bazuar në kërkesat e statutit të njësisë ekonomike.

15. Rezerva rivlerësimi

Paraqitet plus vlera e përealizuar e rivlerësimit të Ndërtesës me vlerën e drejtë. Shuma e paraqitur ka marrë parasysh dhe zbritjen e rezervave të mbartura nga rivlerësimi. Gjatë vitit 2015 rezerva e rivlerësimit është amortizuar me shumën 43,937,770 Lekë

16. Humbja e periudhës

Paraqitet rezultati i periudhës humbje prej 53,031,947 Lekë. Struktura e humbjes detajohet në pasqyrën e rezultatit. Më poshtë tregohet analiza e humbjes.

	2015	2014
Humbja para tatimit	-53,031,947	-69,319,949
Të ardhura të patatueshme	0	-34,735,689
Shpenzime të pazbritshme (a)	52,684,173	60,879,771
Rezultati tatimor	-347,774	-43,175,867
Humbje e mbartur	-43,175,867	0
Baza e llogaritjes së tatimit	-43,523,642	-43,175,867
% e tatim Fitimit	15%	15%
Tatim Fitimi	0	0
Humbja neto e periudhës	-53,031,947	-69,319,949

16.a. Shpenzime të pazbritshme

	2015	2014
Gjopa dhe dëmshpërblime	1,641,158	1,510,527
Donacione	0	1,170,233
Shpenzime pritje përcjellje	3,946,258	2,355,408
Amortizim rezerve rivlerësimi ndërtesa	43,937,770	46,218,704
Shpenzime për interesa	0	9,624,899
Qira uzufrikti e papaguar	2,203,518	0
Humbje nga gabime në vitet e kaluara	955,469	0
Totali	52,684,173	60,879,771

Shpenzimet e mësipërme janë përjashtuar nga rezultati tatimor në referencë të Ligjit Nr. 8438 datë 28.12.1998 Për Tatimin mbi të ardhurat.

Nga totali i shpenzimeve të amortizimit të Ndërtësës prej 78,191,775 Lekë është përjashtuar amortizimi i tepriçës nga rivlerësimi me vlerë 43,937,770 Lekë. Pjesa tjetër e amortizimit të Ndërtësës, që i përket kostos historike të saj është përfshirë në shpenzimet e zbritshme për efekt të llogaritjes së Tatimit mbi fitimin shuma prej 34,254,006 Lekë.

Janë përjashtuar nga rezultati tatimor dhe shpenzimet për gjopa dhe dëmshpërblime, shpenzimet për pritje dhe përcjellje dhe qira të maturuara por të papaguara brenda periudhës ushtrimore.

16.b. Humbja e mbartur

Humbja tatimore e mbartur nga viti 2014 është përfshirë në llogaritjen e tatimit për periudhën korrente. Humbjet tatimore mund të mbarten deri në 3 vjet. Autoritetet tatimore mund që në çdo kohë të inspektojnë librat dhe regjistrimet kontabël brenda 5 viteve në mbyllje të vitit tatimor të deklaruar dhe mund të vendosin vlerësime shtesë për tatimin dhe penalitete. Drejtimi i Shoqërisë nuk është në dijeni të ndonjë rrethane, e cila mund të shkaktojë ndonjë detyrim material në këtë aspekt.

17. Të ardhura nga qiratë

Aktiviteti kryesor i shoqërisë për vitin 2015 është dhënia me qira e godinës. Në vitin 2015 shoqëria ka dhënë me qira ambiente për organizimin e panairëve të ndryshme, të cilat janë organizuar nga shoqëria.

18. Të ardhura të tjera nga aktiviteti

	2015	2014
Rimarrje provizione për llogaritë e arkëtueshme	0	21,268,357
Rimarrje shpenzime për interesa	0	13,467,332
Të ardhura nga Grante Afatgjatë (a)	56,810,448	5,777,332
Shitje mallrash (b)	8,363,216	717,254
Të ardhura të tjera (c)	559,682	5,276,654
Totali	65,733,346	46,506,930

18.a. Të ardhura nga Grante Afatgjatë

Paraqiten rimarrjet në të ardhurat e vitit korrent, të pjesës afatshkurtër të Grantit për vitin 2015, paraqitur në shënimin 13.

18.b. Shitje mallrash

Gjatë periudhës janë shitur dy automjete, të destinuara për shitje me vlerë 6,919,000 Lekë dhe kosto 6,694,420 Lekë. Shitje mallrash të tjera gjatë organizimit të eventeve të ndryshme me vlerë 1,444,216 Lekë dhe kosto 731,319 Lekë. Në datën e mbylljes së pasqyrave financiare nuk ka gjendje inventari mallrash apo të tjera për rishitje.

18.c. Të ardhura të tjera

Në këtë zë përfshihen të ardhura nga fshirja e detyrimeve ndaj garancive me vlerë 226,064 Lekë, shuma 13,174 diferenca nga shitja dhe nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve afatgjata materiale dhe shuma 320,447 Lekë të ardhura të tjera nga shfrytëzimi i godinës.

19. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

	2015	2014
Materiale të para	0	1,373,266
Blerje/Shpenzime mallrash, shërbimesh	7,649,732	753,613
Trajtime të përgjithshme	0	4,296,066
Lëndë djegëse	1,539,449	996,540
Blerje, energji, avull, uje	3,327,702	2,059,327
Produkte promocionale	0	2,120,408
Blerje /Shpenzime të tjera	4,317,461	1,195,098
Totali	16,834,344	12,794,319

20. Shpenzime të personelit

	2015	2014
Pagat dhe shpërblimet e personelit	10,575,890	8,952,840
Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	1,447,045	1,091,157
Totali	12,022,935	10,043,997

Mesatarisht gjatë vitit 2015, shoqëria Prespa Invest shpk ka pasur të punësuar 8 punonjës. Në mbyllje të pasqyrave financiare detyrimi ndaj punonjësve të saj është 1,147,714 Lekë (shënimi 11).

21. Shpenzime të tjera shfrytëzimi

Për zërat si më poshtë,

	2015	2014
Qira	11,780,820	9,954,750
Mirëmbajtje dhe riparime	10,021,849	13,336,007
Sigurime	3,237,017	2,863,196
Të tjera	583,325	1,277,229
Personel jashtë njësisë	4,146,886	3,282,351
Udhëtim	0	1,424,372
Marketing	5,979,717	5,021,525
Telekomunikacion	841,305	889,675
Shërbime bankare	175,540	351,159
Taksa dhe të ngjashme	2,900,151	2,521,020
Pritje përfaqsimi	3,946,258	2,355,408
Gjoha dhe dëmshpërblime	1,641,158	1,510,527
Transport	1,616,541	361,625
Vlera kontabel e aktive afatgjata	0	1,375,190
Donacione	0	1,170,233
Korrigjime të gabimeve në vitet e kaluara	955,469	0
Totali	47,826,036	47,694,268

22. Të ardhura financiare

Për zërat si më poshtë.

	2015	2014
Të ardhura nga interesat	19,111,356	18,301,540
Të ardhura të tjera financiare	409,923	0
Fitim nga kembimet valutore	19,571,322	1,641,652
Totali	39,092,602	19,943,191

23. Shpenzime financiare

	2015	2014
Shpenzime për interesa	28,524,795	46,537,904
Shpenzime financiare të tjera	20,563	175,923
Humbje nga këmbimet valutore	5,602,207	269,949
Totali	34,147,565	46,983,777

24. Aktivët e kushtëzuara

Shoqëria disponon aktive të kushtëzuara, që lidhen me garancitë që i janë lëshuar asaj nga nënkontraktorët për punime të ndryshme të kryera nga ata. Këto të drejta nuk plotësojnë kushtin e njohjes sepse ato janë kërkesa të mundshme që lindin nga ngjarje të shkuara dhe ekzistenca e të cilit do të konfirmohet vetëm nëse ndodh ose nuk ndodh një ose disa ngjarje të ardhshme të pasigurta, të cilat nuk janë nën kontrollin e plotë të njësisë ekonomike. Shoqëria nuk mund të përcaktojë datën e lindjes së këtyre të drejtave dhe shumën e tyre.

25. Palët e lidhura

Një transaksion me palët e lidhura është një transferim i burimeve, shërbimeve apo detyrimeve midis palëve të lidhura, pavarësisht nëse është caktuar një çmim. Një palë është e lidhur me një njësi ekonomike nëse kontrollon, kontrollohet nga, ose është nën një kontroll të përbashkët me njësinë ekonomike; ka një interes në njësinë ekonomike që i jep asaj influencë të konsiderueshme mbi njësinë; ose pala ushtron një kontroll të përbashkët mbi njësinë; pala është një pjesëmarrje e njësisë ekonomike; pala është një sipërmarrje e përbashkët në të cilën njësi ekonomike është një sipërmarrës; ose një nga anëtarët e personelit drejtues të njësisë apo të shoqërisë mëmë të saj (duke përfshirë familjarë të afërt të ndonjërit prej individëve të referuar më sipër)

Më poshtë paraqiten balancat ndaj palët së lidhur, shoqërisë Prespa Import Eksport dhe Z. Loritan Prespa.

	2015	2014
Prespa Import Eksport		
Llogari të pagueshme	-3,405,342	-6,242,442
Huadhënie afatgjata	96,809,126	98,170,626
Interesa të arkëtueshme	0	2,528,556
	93,403,784	94,456,740
Loritan Prespa		
Huadhënie afatshkurtër	4,648,928	4,598,928
	4,648,928	4,598,928
Totali	98,052,712	99,055,668

26. Ngjarjet pas datës së bilancit

Nuk ka ngjarje të tjera pas datës së raportimit të cilat kërkojnë rregullime apo informacione shpjeguese shtesë në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

27. Miratimi i pasqyrave financiare

Këto pasqyra financiare të rishikuara janë miratuar nga organi ekzekutiv, dhe janë autorizuar për t'u publikuar më 02 Mars 2016.



FORMULAR I DEKLARIMIT DHE
PAGESES SE TATIMIT MBI FITIMIN

Numri i Vendorsjes se Dokumentit (NVD)
(Vetem per perdorim zyrtar)



(2) Periudha tatimore

15-A

(1) Numri Serial: _____

Numri Identifikues i Personit te Tatueshem (NIPT): (3) K72117025C
Emri Tregtar i Personit te Tatueshem: (4) PRESPA INVEST
Emri Mbiemri i Personit Fizik: (5) _____
Adresa: (6) Njësia Bashkiake Nr. 11, Rruga Gjergj Balsha, Nd.
6, Kodi postar 1029
Qyteti/Komuna/Rrethi: Tirana, Tirane, Tirane
Numri Telefonit: (7) _____

Lajmëroni nëse informacioni i mësipërm është jo i plotë ose ka ndryshuar

Llogaritja e rezultatit

Te ardhurat dhe shpenzimet

(8/9) Te ardhurat

(10/11) Shpenzimet

(12) Shpenzimet e pazbritshme

Të ushtrimit

Tatimore

(8)	140,377,743	(9)	140,377,743
(10)	193,409,690	(11)	193,409,690
		(12)	52,684,173

Rezultati

(13/14) Humbja

(15/16) Fitimi

(17) Humbje e mbartur

(18) Fitimi i tatueshem neto (16-17)

(13)	53,031,947	(14)	347,774
(15)	0	(16)	0
		(17)	0
		(18)	0

Llogaritja e tatim fitimit

(19) Tatim fitimi me shkallen tatimore standarte

(20) Tatim fitimi me perqindje te tjera

(21) Tatim fitimi (19+20)

(22) Tatim fitimi i shtyre

(23) Tatim Fitimi i detyrueshem për t'u paguar

(19)	0
(20)	0
(21)	0
(22)	0
(23)	0